



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Nëntor, 2017

SBASHK-u në Konferencën “Të veprimtari të bashku për arsim më të mirë”

Kontribut i lartë i SBASHK-ut për ndryshime pozitive në arsimin e Kosovës



Një delegacion i SBASHK-ut, kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për PISA 2018 "Të veprimtari të bashku për arsim më të mirë", të organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft ... (faqe 5)

Takime pune të SBASHK-ut me Ministrin e MASHT, z. Bytyqi

Angazhim dhe përkushtim lidhur me Projektligjin për punëtorët e arsimit të viteve të 90-ta



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj i shoqëruar(faqe 7)

Afër përmbylljes së suksesshme të vitit zgjedhor në SBASHK

Unitetit i lartë rreth SBASHK-ut në Universitete dhe në komunitat e Kosovës

Siç ju kemi informuar me kohë SBASHK-u...(faqe 8)

Intervistë me veprimtarin e SBASHK-ut z. Sadik Shala

Sadiku Mësues, kolegë dhe sindikalist shembullor

Me punë e angazhime krijoi respekt të lartë kudo që punoi. U bë shumë i dashur edhe në SBASHK. Pas dekadave të kaluara në misionin e ... (faqe 3)

Takime pune të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

U aprovua projekt-buxheti për vitin 2018



Në kuadër të realizimit të agjendës së punës fillimisht Kryesia e pastaj edhe Këshilli Drejtues ... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Nëntori i ngjarjeve të mëdha në historinë tonë



Në çdo nëntor shqiptarët lartësojnë kujtimet për personazhet e datave e ngjarjeve të mëdha , që kanë lënë gjurmë në historinë e kombit tonë. Nëntori na kthen kujtesën te Kongresi i Manastirit, te kjo ngjarje e madhe e alfabetit shqiptar.

Më 14 nëntor 1908 personalitete të shquara të arsimit e kulturës sonë u morën vesh për alfabetin tonë për t'u shkruar me të fjalët me vepra kulmore të letërsisë sonë kombëtare.

Nëntori na kujton edhe datën 28 të vitit 1912. Na

kujton Vlorën dhe plakun e urtë Ismajl Qemajli. Na kujton flamurin kombëtar . Në çdo 28 nëntor shqiptarë nga gjithë trojet etnike lartësojnë kujtimin për këtë ngjarje madhore përmes fjalës së thënë bukur dhe këngëve të kënduara për flamurin dhe pavarësinë.

Nëntori shpalos para nesh figurën emblemë të komandantit legjendar Adem Jashari, që me luftë e sakrificë i ndryshoi kahet historisë dhe me gjak vulosi ardhmërinë tonë dhe lirinë.

Nëntori ishte dhe mbetet muaj i kujtesës dhe krenarisë për datat dhe ngjarjet e mëdha të historisë sonë kombëtare.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me veprimtarin e SBASHK-ut z. Sadik Shala

Sadiku Mësues, kolegë dhe sindikalist shembullor



Me punë e angazhime krijoi respekt të lartë kudo që punoi. U bë shumë i dashur edhe në SBASHK. Pas dekadave të kaluara në misionin e edukimit të brezave u pensionua, por vazhdon të jetë aktiv në sindikatë.

U nderua me shumë

mirënjohje, por ne po veçojmë titullin qytetar nderi i qytetit të Përmetit, dhe nderi i komunës së Frashrit në Shqipëri me motivacione për kontributin arsimor, kulturor e kombëtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. “Po të kisha edhe një jetë pune tërë qenien time do t’ia kushtoja edhe më me përkushtim edukimit dhe arsimimit të brezit të ri, perspektivës sonë”, e thotë nga zemra Sadiku në intervistën për gazetën tonë “Arsimimi sot”.

Arsimimi sot :

Kush është Sadik Shala ?

Sadiku:

Sadik Shala është qytetar nga Suhareka. Shkollën Fillore e mbaroi në vendlindje, kurse shkollën normale në Prizren. Diplomoi në vitin 1973, ku pas diplomimit filloi punën në shkollën Fillore “Aradha e Sharrit” në fshatin Greikoc. Atëkohë ishte shumë i vështirë udhëtimi meqë nuk kishte transport të organizuar deri në fshat. Udhëtoja në këmbë për çdo ditë nga 6 km në këmbë. Dëshira e madhe për punë me nxënës ishte shumë më e madhe se sa vështirësitë që më dilnin para. Në Greikoc kam vazhduar kështu për 22 vite pa ndërprerë, duke arritur rezultate shumë të mira në edukimin dhe arsimimin e nxënësve. Për shkak të situatë së vështirë që përballej arsimit shqip në Kosovë u detyrova që nga viti 1994 të kaloj në shkollën fillore “Flamuri i Arbrit” në fshatin Reshtan ku kam vazhduar deri në pensionim në vitin 2016. Gjatë tërë karrierës sime të punës në arsim por edhe në aktivitete jashtëshkollore, e të aktivitetit për aktivitete shoqërore

e politike të komunitetit ku kam jetuar e vepruar jam munduar

Arsimimi sot :

Sadiku veprimtar i shquar sindikal dhe në kulturë

Sadiku:

Të lë përshtypje të larta bashkëpunimi e besimi me bashkëpunëtorë që i kam pasur të shumtë. Gjatë punës sime në shkollë disa herë jam nderuar me mirënjohje për punën me nxënës, në mësim, aktivitete sportive e kulturore. Jam i nderuar me titullin qytetar nderi i qytetit të Përmetit, dhe nderi i komunës së Frashrit në Shqipëri me motivacione për kontributin arsimor, kulturor e kombëtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Arsimimi sot :

Cili është aktiviteti juaj në sindikatë ?

Sadiku:

Në vitin 2007 kam iniciuar themelimin e degës së SBASHK-ut në Komunë e Suharekës, kur edhe u zgjedha kryetar i parë i aktivitetit sindikal në Suharekë. Me punë dhe angazhim të pa kursyer arritëm të anëtarësojmë më se 900 anëtarë sindikal të arsimit. Gjatë tërë kësaj kohe nuk mungonin sukseset kur përballëshim me sfida të mëdha për mbrojtjen e interesit të punëtorit të arsimit. Për mbrojtjen e interesit të punëtorit arsimor në vitin 2007 kam marrë pjesë në grevën e urisë, grevë e cila ia ktheu dinjitetin punëtorit arsimor. Me rastin e daljes në pension dhe dorëzimit të detyrës që e kam mbajtur për 8 vite në mbrojtje të interesit të mësuesit, u propozova për kryetar nderi i degës së SBASHK-ut në Suharekë, ku ky propozim u pranua njëzëri nga kuvendi i anëtarëve të degës, ku edhe më tej jap kontributin tim me këshilla të cilat vlerësohen nga anëtarësia e gjerë.

Realisht çdo punëtor i arsimit nuk mundë të shkëput aktivitetin e tij me të dalë në pension. Këtu ndërthuren aktivitete që në vazhdimësi përcillen edhe më tej. Në çdo shkollë të Komunës sime kam miq dhe kolegë të cilët jam i mirëpritur dhe këshillohem për problemet dhe sfidat e kohës në arsim.

Arsimimi sot :

SBASHK me je fitoi betejën ën Gjykatën e Suharekës, na tregoni me shumë për këtë

Sadiku:

SBASHK-u me ne fitoi betejën në Gjykatën e Suharekës. Në bazë të Kontratës Kolektive, të gjithë punëtorët e Arsimit të pensionuar nga data 01.01.2015, marrin nga 3 paga përcjellëse dhe nga paga jubilarë. Në bazë të kësaj i kemi udhëzuar anëtarët tanë të pensionuar që të ndjekin procedurat e caktuara me ligj duke iu drejtuar fillimisht DKA-së Komunale me kërkesë të arsyetuar sipas Kontratës Kolektive. DKA në pamundësi të kompensimit material nuk mund ta anashkalonin edhe të drejtën tonë sipas Kontratës Kolektive për çka lëndës sonë i jepej e drejta për ankesë në Komisionin Komunal për ankesa dhe parashtrësia. Detyrimisht ky komision e pranonte të drejtën ligjore për shpërblim material të pensionistit të arsimit por për shkak të pamundësive materiale nuk mund të realizohej kjo e drejtë. Pas këtyre vazhdonte procedura në padi ndaj DKA-së dhe Komunës në Gjykatën Komunale. Në arsyetimet e specifikuar në Kontratën Kolektive gjykata vendoste duke i dhënë të drejtë punëtorit për shpërblimet e merituar.

Arsimimi sot :

Sa nga punëtorët e pensionuar të arsimit në Suharekë janë përfituesit

Sadiku:

Sipas kësaj ecurie deri më tani i kanë realizuar të drejtën e tyre për kompensim rreth 30 punëtorë, aktualisht janë në vazhdim të procedurave edhe pjesa tjetër sipas afateve ligjore të përcaktuara me ligj.

Arsimimi sot :

Ju jeni pensionuar , por ende vazhdoni të jeni në SBASHK-u, pse?

Sadiku:

Aktualisht aktiviteti im sindikal në SBASHK është pa shkëputje edhe pas pensionimit. Duke e parë interesin e punëtorëve sindikalist që dilnin në pension dhe mbeteshin pa mbështetje ligjore, me inicimin e qendrës së SBASHK-ut në Prishtinë u vendos që të themelohej organizatë sindikale e pensionistëve të arsimit në përbërje të SBASHK-ut. Në kuvendin themelues jam zgjedhur nënkryetar i SBASHK-ut për pensionistë të arsimit. Qëllimi kryesor i saj është që edhe pas pensionimit, punëtorët e arsimit të gëzojnë mbështetje sindikale të organizuar. Duke iu falënderuar fillimisht gjendjes sime të mirë shëndetësore dhe dëshirës sime për të kontribuar edhe më tej jam në gjendje të vazhdoj kontributin tim në interes të aktivitetit arsimor e edukativ për gjeneratat e reja.

Arsimimi sot :

Këshilla juaj për kolegët tuaj të pensionuar dhe për ata që janë ende në arsim

Sadiku:

Në çdo vend të botës bëhet aktiviteti i organizimit sindikal, sepse është i vetmi organ që interesohet për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Prandaj iu bëjë thirrje që punëtorët arsimor të pensionuar të anëtarësohen në organizimin e kësaj sindikate në komunat e Kosovës. Përveç mbështetjes që e ceka më lartë për përfitimet e shpërblimeve me rastin e daljes në pension, ata mund të përfitojnë edhe në marrëveshjet që SBASHK-u ka bërë gjithandej në Kosovë.

Arsimimi sot :

A keni diçka të veçantë për të shtuar ?

Sadiku:

Po të kisha edhe një jetë pune tërë qenien time do t'ia kushtoja edhe më me përkushtim edukimit dhe arsimit të brezit të ri, perspektivës sonë.

Gjatë muajit

SBASHK-u në Konferencën “Të veprojmë së bashku për arsim më të mirë”

Kontribut i lartë i SBASHK-ut për ndryshime pozitive në arsimin e Kosovës

Një delegacion i SBASHK-ut, kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për PISA 2018 "Të veprojmë së bashku për arsim më të mirë", të organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.



Në këtë Konferencë të pranishëm ishin edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Ramush Haradinaj, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Shyqiri Bytyqi, zv/Ministrja e Arsimit të Shqipërisë znj.Besa Shahini, Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë z.Christian Heldt dhe personalitete tjera ndërkombëtare dhe vendore. Në fjalën e rastit Kryeministri Haradinaj, ka thënë se "Kemi Testin PISA, i cili është nxjerr i dobët. Më së miri për ne është t'i shohim shkaqet pse është kështu", duke shprehur gatishmërinë për kontributin e tij dhe të Qeverisë për të ndryshuar këtë gjendje.



Gjithashtu Kryeministri tha se mos koordinimi në mes të Ministrisë së Arsimit dhe të Komunave, shpie deri te një implementim jofunksional, duke shprehur

bindjen se edhe plan- programet shkollore për nivelin fillor dhe të mesëm, janë ende eksperimentale, dhe se shkollat tona janë punuar vetëm si objekte dhe jo si qëllim edukimi, duke mos dhënë porosinë si institucion arsimor.



Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Bytyqi në fjalën e tij përshëndetëse tha se reformat në arsim duhet të sjellin ndryshim pozitiv, jo vetëm në rezultate arsimore, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe si e tillë këtë gjë duhet bërë bashkërisht. Ministri, me këtë rast ka falënderuar Qeverinë Gjermane, e cila ka ofruar përvojat më të mira ndërkombëtare sa i përket testit PISA, ndërkaq shtoi se MASHT ka mbështetjen e fuqishme të Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e cilësisë së arsim.



Ndërkaq Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jashari si pjesë e panelit prezantoi "Deklaratën e Prishtinës" – Roli i mësimdhënësve dhe rekomandimet që kanë dalë nga konferenca e organizuar nga SBASHK dhe GIZ gjatë muajit tetor me temën "Mësimdhënësit formojnë të ardhmen e Kosovës", ku theksoi se SBASHK-u si çdoherë edhe tani përveç rolit që ka për mbrojtjen e mësimdhënësve, me gjithë potencialin e vet angazhohet edhe për ngritjen e cilësisë në arsim. E kjo më së miri dëshmohet edhe me realizimin e konferencës së lartcekur, nga e cila konferencë dolën edhe rekomandimet lidhur me PISA 2018, ku do ti cekim disa nga ato:

- Arsimi në Kosovë ka nevojë dhe duhet të krijojë kapacitetet për një qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor dhe efikase në institucionet arsimore të të gjitha niveleve në shkallë vendi.
- MASHT duhet vazhdimisht të ngrit cilësinë dhe të sigurojë gjithëpërfshirje në arsimin fillor dhe të mesëm, duke siguruar përfshirje të shtuar të fëmijëve në edukimin parashkollor.
- Ndërtimi i mekanizmave dhe funksionalizimi i tyre për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve dhe ofrimi i shërbimeve cilësore në shkollë. Kjo të rregullohet edhe Udhëzim Administrativ për hartimin e Planit Individual të zhvillimit profesional të mësimdhënësit.
- Krijimi i mjedisit miqësor, të shëndetshëm dhe të sigurtë për të gjithë komunitetin e shkollës, duke krijuar ambient shkollor joshës për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit.
- MASHT duhet të siguroj sistem dhe mundësi për avancimi të mësimdhënësve në karriere - ngritje të vazhdueshme profesionale.
- Furnizimi i shkollave me material konkretizues të mësimin si dhe pajisje teknologjike dhe kabinetike për

lëndë dhe fusha kurrikulare.

- Trajnimet e mësimdhënësve për kurrikulën e re të jenë në vazhdimësi dhe mësimdhënësi duhet të ketë rol dominues në hartimin e planprogrameve kurrikulare në bashkëpunim me MASHT.
- Përpilimi urgjent i teksteve shkollore, tekste të reja në baze të reformave kurrikulare, me pjesëmarrjen e mësimdhënësve nga edukimi parafillor deri të mësimdhënësit e shkollave në arsimin e mesëm të lartë.
- MASHT –i të ketë efekt pozitiv duke prezantuar e diskutuar përparësitë dhe mangësitë e Testit PISA duke ngritur vëmendjen për rëndësinë dhe efektin e rezultateve në raport me punën në shkolla dhe në njësitë akademike që përgatisin mësimdhënësit.
- MASHT-i dhe partnerët duhet të mbështesin trajnimin e mësimdhënësve në nivel vendi, sidomos në fushat/lëndët të cilat janë objekt i testimit në testin PISA. Trajnimet specifike të orientohen në zhvillim e shkathtësive dhe njohurive në lexim-kuptim, matematikë dhe shkenca.
- MASHT-i të filloj sa më parë hartimin e teksteve shkollore bashkëkohore, me udhëzues për mësimdhënësit, libër të nxënësit dhe materiale tjera mësimore me detyra të zbatueshme dhe të nevojshme në jetën e përditshme.
- Të marrë pjesë aktive në "grupe të ndryshme punuese të MASHT dhe akterëve tjerë për të përfaqësuar dhe mbrojtur pozitën dhe statusin e mësimdhënësve të Kosovës.
- Të sigurohet dhe të mbështetet zbatimi i kontratës kolektive dhe licencimi e avancimi në karrierë të mësimdhënësve.
- Përfaqësimi dhe përfshirja aktive në procese vendimmarrje, komisione e këshilla, për të fuqizuar rolin e mësimdhënësve si promotor dhe bartës kryesor për avancim të cilësisë në arsim.

Takime pune të SBASHK-ut me Ministrin e MASHT, z. Bytyqi

Angazhim dhe përkushtim lidhur me Projektligjin për punëtorët e arsimit të viteve të 90-ta

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë vazhduar me përpjekjet dhe takimet me përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës duke kërkuar nga ata që me angazhime të shtuara ta përmbyllin drejt çështjen e Projektligjit mbi statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Kjo ishte temë kyçe edhe në takimin e radhës me Ministrin në MASHT, z. Shyqiri Bytyqi.



Ministri Bytyqi i ka deklaruar SBASHK-ut se është formuar një komision në MASHT për ta analizuar edhe një herë këtë projektligj dhe janë duke u bërë

përpjekje maksimale që ai të shkoi në qeveri në pjesën e parë të dhjetorit me qëllim që pastaj të procedohet në Parlament. punëtorëve të arsimit të viteve të 90-ta dhe po komisioni që kam ngritur po bën një punë shumë dinamike me qëllim që Projektligji të shkojë në Qeveri në pjesën e parë të dhjetorit e pastaj të procedohet me një herë në Parlament", i ka thënë delegacionit të SBASHK-ut, Ministri Bytyqi.

Në kuadër të këtij takimi delegacioni i SBASHK-ut i ka prezantuar Ministrin Bytyqi edhe gjithë kërkesat e punëtorëve të arsimit, që dalin nga Kontrata Kolektive duke kërkuar angazhimin e tij që qeveritë komunale të angazhohen seriozisht për realizimin e tyre. dhjetorit me qëllim që pastaj të procedohet në Parlament.

Takime pune të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

U aprovua projekt-buxheti për vitin 2018



Në kuadër të realizimit të agjendës së punës fillimisht Kryesia e pastaj edhe Këshilli Drejtues i SBASHK-ut kanë dëgjuar Raportin financiar janar –tetor 2017 e pastaj edhe Projektbuxhetin për vitin 2018.



Këto dy dokumente të rëndësishme në takime të ndara të kryesisë dhe Këshillit Drejtues i ka paraqitur menaxheri për financa Ymer Ymeri. Të dy këto organe të larta të SBASHK-ut kanë aprovuar edhe Raportin financiar janar –tetor 2017 e pastaj edhe Projektbuxhetin për vitin 2018.



Vlen të përmendet se në takimin e Kryesisë u paraqit edhe angazhimi i kryetarit Jasharaj për ndryshimet që duhet bërë në Rregulloren për Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave në SBASHK dhe Rregulloren për shtesat në pagë, kompensime të tjera dhe ndalesa për anëtarët e Kryesisë Kryesia përkrahu propozimin e kryetarit për plotësim-ndryshimet e Rregulloreve të lartëcekura, që janë kompetencë e Kryesisë së SBASHK-ut.

Afër përmbylljes së suksesshme të vitit zgjedhor në SBASHK

Unitetit i lartë rreth SBASHK-ut në Universitete dhe në komunat e Kosovës

Siç ju kemi informuar me kohë SBASHK-u e kishte shpallur vitin 2017 vit zgjedhor dhe ishin filluar me kohë përgatitjet për një proces sa më të mirë e transparent. Janë kryer fillimisht zgjedhjet nëpër shoqata sindikale të institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe në Universitete e pas kësaj janë mbajtur sipas planifikimit dhe agjendës së Këshillit Drejtues zgjedhjet në nivel të Kuvendeve nëpër komunat dhe Universitetet e Kosovës.



Do të jenë në këtë takim të rëndësishëm përfaqësues nga të gjitha Universitetet për të zgjedhur kryetarin, nënkryetarin dhe kryesinë e organet tjera të Kuvendit të SUSHK-ut. Kjo ngjarje, që mbahet më 15 dhjetor ka zgjuar interesim të madh mes sindikalistëve në Universitete dhe janë duke u bërë gjithë parapërgatitjet që Kuvendi të jetë plotësisht i suksesshëm.

Duke respektuar në plotësi agjendën e Këshillit Drejtues për zgjedhjet, ato janë mbajtur në Kuvendin sindikal të Universiteteve “Hasan Prishtina” të Prishtinës, “Isa Boletini” të Mitrovicës, Universitetin e Ferizajt dhe në atë “Ukshin Hoti” të Prizrenit për të zgjedhur me votën e lirë dhe të fshehtë kryetarët, nënkryetarët dhe kryesinë sindikale atje.



Kjo ka krijuar mundësinë që të caktohet data e mbajtjes së Kuvendit zgjedhor në nivel të SUSHK-ut, që është pjesë përbërëse e SBASHK-ut.

Në këto Kuvende ka qenë i pranishëm kryetari i SUSHK-ut, Bardh Bardhi i shoqëruar nga anëtarë të kryesisë, i cili ka shpallur arritjet, por është ndalur edhe të sfidat që presin dhe detyrat që duhet realizuar në shërbim të anëtarësisë. Ai ka përcjellë përshëndetjet

e kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj , i cili për arsye të aktiviteteve të shumta e të rëndësishme nuk ka mundur të jetë i pranishëm në këto veprimtari sindikale.



Edhe në komuna zgjedhjet në kuvendet sindikale u zhvilluan sipas agjendës

Krahas këtij aktiviteti në Universitete ka vazhduar drejtë përmbylljes edhe aktiviteti zgjedhor në Kuvendet e SAF e SAM në Drenas, Malishevë, Gjakovë e Therandë . Në të gjitha këto Kuvende kanë qenë të pranishëm kryetari i SBASHK-ut



Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Ne u kemi mbajtur të informuar për këto aktivitete zgjedhore përmes ueb faqes sonë. Ajo që do kujtuar edhe në këtë shkrim është uniteti i shkëlqyer dhe besimi i plotë i anëtarësisë , në këtë komuna dhe në

tërë Kosovën ndaj SBASHK-ut.



Anëtarët e këtyre Kuvendeve pasi kanë shpalosur raportet e punës dhe ato financiare, kanë dëgjuar me kujdes këshillat e z. Ymer Ymeri, që në Kuvendet zgjedhore ka marrë pjesë në cilësinë e kryetarit të Komisionit statutar.



Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor dhe me votën e fshehtë e në një garë të fortë mes dy e më shumë kandidatëve për secilin post janë zgjedhur kryetarët, nënkryetarët, anëtarët e kryesisë, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe anëtarët e Këshillit Drejtues nga këto komuna. Raportet nga këto Kuvende janë ruajtur në arkivin e SBASHK-ut.

SBASHK-u reagoi ndaj idesë së Ministrit Bytyqi për mësimin tërë ditor

Eksperimentet e vazhdueshme e kanë dëmtuar arsimin në Kosovën e pasluftës



Idenë e Ministrit Shyqiri Bytyqi për arsimin tërë ditor në Kosovë dhe deklarimin e tij se "MASHT synon që në vitin e ardhshëm të fillohet mësimi

tërë-ditor në ato shkolla që ka kushte, mirëpo, sipas identifikimit të kësaj Ministrie, vendit i duhen të ndërtohen edhe 142 objekte shkollore dhe 85 anekse, prej tyre shkolla fillore, shkolla të mesme të larta dhe salla të edukatës fizike që është 218 në tërë Kosovën,

ndërsa vlera investive e të gjitha këtyre është rreth 371 milionë euro", SBASHK-u e konsideron si edhe një eksperiment të ri e të dëmshëm ndaj sistemimit arsimor në Kosovë.

Sipas praktikave të vendeve të Evropës nuk janë mësimdhënësit e njëjtë ata që angazhohen gjatë tërë mësimin tërë ditor. Janë kuadro të tjera arsimore e mbështetëse që angazhohen pas dite më nxënës. SBASHK i kujton MASHT-it dhe DKA-ve se me mësimdhënësit që tani janë në sistemin arsimor nuk mund të mendohet aplikimi i mësimin tërë ditor sepse ata kanë normat e tyre të plota 20 orë mësimore me nxënës dhe 20 orë të tjera për përgatitje për procesin mësimor dhe për komunikim me nxënës e me prindër dhe prandaj ata nuk mund të obligohen që të punojnë mbi këtë normë të përcaktuar me Ligj dhe me Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës. Është e natyrshme që SBASHK-u e përcjell me kujdes çdo paraqitje publike të MASHT-it dhe analizon në detaje çdo ide të re lidhur me arsimin , që vjen nga Ministri dhe institucionet tjera të shtetit tonë. Pra, SBASHK i kujton MASHT-it dhe DKA-ve se me mësimdhënësit që tani janë në sistemin arsimor nuk

mund të mendohet aplikimi i mësimin tërë ditor sepse ata kanë normat e tyre të plota 20 orë mësimore me nxënës dhe 20 orë të tjera për përgatitje për procesin mësimor dhe për komunikim me nxënës e me prindër dhe me kërkesat e Kurikulit të ri atyre do t'u duhen edhe shumë e shumë orë të tjera angazhim për të realizuar kompetencat dhe detyrat e tyre prej mësimdhënësi. Këta mësimdhënësit nuk mund të obligohen që të punojnë mbi këtë normë të përcaktuar me Ligj dhe me Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës. Pra, nëse shkohet në këtë eksperiment të mësimin tërë ditor dhe nëse veprohet si në Evropë dhe iu mundësohet që vetë nxënësit të deklarohen dhe nëse supozojmë se vetëm gjysma e 369.309 nxënësve, sa janë në Arsimin Parauniversitar, angazhohen në këtë lloj mësimi atëherë duhet angazhuar edhe rreth 6000 kuadro të reja arsimore dhe duhet siguruar pagat e tyre, për të cilat kërkohen jo më pak se rreth 33 milionë euro në vit. Po nëse të gjithë nxënësit e Kosovës do ta preferonin shkuarjen në mësimin tërë ditor atëherë, do të duhej angazhuar edhe rreth 12.000 kuadro të reja arsimore dhe buxhetin shtesë prej rreth 66 milionë euro për cdo vit.